

# E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Fokusi i muajit

Konsultimi publik i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.

Zyra e Komisionerit ka hartuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Domosdoshmëria për ndryshime ligjore në fushën e së drejtës për informim erdhi si rezultat i problematikave të konstatuara gjatë zbatimit të tij, por edhe si rezultat i sugjerimeve dhe propozimeve të vazhdueshme të grupeve të interesit.

Zyra e Komisionerit vlerësoi se përmirësimi i kuadrit ligjor do të ndikojë ndjeshëm në aksesin më të madh të qytetarëve në informacionin/dokumentacionin publik, konsolidimin e kompetencave mbikëqyrëse të institucionit dhe forcimin e rolit të koordinatorit. Këto ndryshime u panë edhe në optikën e reduktimit të hapësirave për korrupsion në administratën publike si dhe mirëfunksionimin e shtetit ligjor.

Në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ministria e Drejtësisë ka publikuar në “Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, ftesën “Për pjesëmarrje në procesin e dhënies së informacioneve ose opinioneve paraprake, për çështje apo problematika me të cilat grupet e interesit janë hasur gjatë zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, si dhe dhënien e propozimeve konkrete për ndryshime në ligj.

Projektligji “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, aktualisht rezulton në fazën e konsultimit me publikun, dhe është publikuar nga Ministria e Drejtësisë në RENJK për të marrë sugjerime dhe opinione nga grupet e interesit, sugjerime të cilat i shërbejnë përmirësimit të ligjit për të drejtën e informimit, garantimit të së drejtës për informim dhe rritjes së nivelit të transparencës së autoriteteve publike”.

Njoftimi për konsultimin me publikun është bërë në linkun <https://konsultimipublik.gov.al>.

## Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

[Vendim Nr. 19 - Banka Shqipërisë](#)

[Vendim Nr. 20 - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve](#)

[Vendim Nr. 21 - Operatori i Sistemit të Transmetimit](#)

[Vendim Nr. 22 - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave](#)

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT  
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI [WWW.IDP.AL](http://WWW.IDP.AL)

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit korrik 2022, ka dhënë 4 vendime urdhërimi për vënien në dispozicion të dokumentacionit në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 21 datë 05.07.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Operatorit të Sistemit të Transmetimit", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion një kopje e regjistrave të realizimeve të prokurimeve publike nga autoriteti publik për vitet 2017 - 2021. Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke cituar: "Të dhënat e kërkuara janë të publikuara dhe pasqyruara në rubrikat përkatëse pranë Agjencisë së Prokurimit Publik. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a, ka lidhur gjithmonë kontrata në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Për këtë arsye, të dhënat në lidhje me kontratat mund të merren lehtësisht në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Pas përgjigjes së sipërcituar, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI.

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, Zyra e Komisionerit ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 21.06.2022 me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik kërkuar kohë për rivlerësimin e dhënies së dokumentacionit të kërkuar, kërkesë e cila u pranua nga Zyra e Komisionerit dhe ankuesi.

Brenda afatit të kërkuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik, si dhe deri në datën e këtij vendimi, Autoriteti Publik nuk pati asnjë reagim mbi qëndrimin përfundimtar në lidhje me vënien ose jo në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri

## #informim #transparencë #vendim

vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me regjistrat e realizimeve të prokurimeve publike nga Autoriteti Publik, i cili i nënshtrohet gjithashtu dispozitave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (ligji i zbatueshëm në atë periudhë), si dhe ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik".

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik se informacioni i kërkuar gjendet lehtësisht në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al). Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

Në përgjigjen e dhënë, konstatohet se Autoriteti Publik ka referuar faqen zyrtare të institucionit, ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresën e saktë të tij, në mënyrë të tillë që informacioni të gjendet lehtësisht nga kërkuesi.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: "Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...". Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t'i tregojë ankuesit adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën gjendet informacioni i kërkuar.

Gjithashtu, fryma e përgjithshme e legjislacionit për prokurimin publik është të sigurojë integritet, besim në publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publik sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë.

Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, theksojmë se, bazuar në gërmën ë), pika 1, të nenit 7 të LDI dhe Urdhrit nr.187 datë 18.12.2020 "Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar" i ndryshuar, të Komisionerit, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e autoritetit publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Për tu njohur me vendimin e plotë të Zyrës së Komisionerit klikoni në faqen zyrtare [www.idp.al](http://www.idp.al)

## “Dita e Transparencës” me Autoritetet Publike të Qarkut Kukës

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me ambasadën e Britanisë së Madhe, zhvilluan takimin e katërt të iniciativës “Ditët e Transparencës”, me autoritete publike të qarkut të Kukësit. Ky aktivitet kishte si objektiv vlerësimin e ecurisë të zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” me qëllim garantimin e kësaj të drejte dhe nxitjen e transparencës proaktive e llogaridhënies së institucioneve publike.

Në takim morën pjesë znj. Elona Hoxhaj, Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, z. Alastair King-Smith, Ambasador i Britanisë së Madhe në Shqipëri, z. Ali Hallaçi, Prefekt i Qarkut, z. Safet Gjici, Kryetar i Bashkisë Kukës, si dhe drejtues/përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve të sistemit të drejtësisë, strukturave rajonale të institucioneve të varësisë dhe koordinatorët për të drejtën e informimit.



Përmeshja e detyrimeve rregullatore në këtë fushë është faktor përmirësues edhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve që këto autoritete publike ofrojnë për qytetarët. Nga monitorimi periodik dhe analiza e situatës, Zyra e Komisionerit konstaton domosdoshmërinë për efektivitet më të madh në përditësimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve, në të gjithë elementët e tyre përbërës. Në takim u kërkua nga koordinatorët angazhim për rritjen e cilësisë në procesin e trajtimit të kërkesave për informacion nga qytetarët apo grupet e interesit, si dhe u garantua bashkëpunim konstant me ta për forcimin e kulturës së transparencës.



## Aktivite ndërgjegjësuere në Qarkun Kukës

Gjatë ditës së Transparencës në Kukës, përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit udhëtuan dhe në qytetet Krumë dhe Bajram Curri për të takuar nga afër përfaqësuesit e Bashkisë Has dhe Tropojë të cilët janë të angazhuar drejtpërdrejtë në përditësimin e programeve të transparencës dhe në përgjithësi me zbatimin e ligjit për të drejtën e Informimit.

Zyra e Komisionerit ndau me pjesëmarrësit praktikën më të mirë të transparencës proaktive dhe të çështjeve më të ndjeshme që prekin qytetarët në lidhje me informacionin publik.



Gjithashtu, gjatë zhvillimit të Ditës së Transparencës, stafi i Zyrës së Komisionerit shpërndau për qytetarët në disa stenda, materiale ndërgjegjësuere për ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim,

